BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES

MBIKËQYRJA BANKARE
RAPORTI VJETOR 2001

Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,
Tiranë, Shqipëri
Tel: 355-4-222230; 235569; 23558; Fax: 355-4-223558

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni zj.Adriana Meko,
Zyra e Botimeve dhe e Politikave Monetare
Departamenti i Kërkimeve.
Punoi në kompjuter: Zj.Arianita Qilimi
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi: 1000 kopje

PËRMBAJTJA

1. HYRJE *5*

2. AMBJENTI BANKAR *6*

2.1. Karakteristikat e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2001 *6*
2.2. Ndryshimet ligjore që ndikojnë në aktivitetin bankar *7*

3. FUNKSIONET E MBIKËQYRJES BANKARE *9*

3.1 Analiza e sistemit bankar *9*
3.2 Inspektimet në vend dhe masat korrektuese *22*
3.3 Licencimi dhe rregullimet bankare *25*

4. LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË *28*

4.1. Banka dhe degë të bankave të huaja *28*
4.2. Subjekte jobanka *31*
4.3. Zyra të këmbimeve valutore *33*

5. LISTA E RREGULLOREVE TË MBIKËQYRJES BANKARE NË FUQI DERI NË QERSHOR 2002 *40*

1. HYRJE

Të rejat në fushën e teknologjisë, novacionet financiare dhe liberalizimi i tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare kanë ndryshuar kushtet në të cilat punojnë bankat dhe kanë pasur efekte në politikat monetare dhe stabilitetin e sektorit financiar. Bankave u është dashur të përballojnë konkurrencën edhe të institucioneve financiare jobanka. Në shumë raste bankat u janë përgjigjur këtyre ndryshimeve me konsolidimin dhe zgjerimin e produkteve dhe të shërbimeve që ato ofrojnë. Në të njëjtën kohë me konsolidimin dhe zvogëlimin e dallimeve midis bankave dhe ndërmjetësve financiarë jobanka, është ngritur vazhdimisht edhe çështja e stabilitetit të sistemit dhe të funksionit të bankës qendrore si huadhënës i burimit të fundit.

Kjo tendencë e përgjithshme botërore është reflektuar edhe në sistemin bankar shqiptar jo aq në drejtim të konsolidimit sa në shtimin e numrit të subjekteve jobanka që janë hedhur në treg.

Nga ana tjetër, pas tre vitesh ekzistence, euro u shndërrua në një realitet të prekshëm për më shumë se 300 milionë qytetarë të eurozonës. Viti 2001 përgatiti futjen fizike të monedhës në 14 vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Kushtet ekonomike në eurozonë u keqësuan si rezultat i ngadalësimit ekonomik global që filloi të materializohej gjatë fundit të vitit 2000. Sulmet terroriste në Shtetet e Bashkuara rritën pasigurinë dhe ndikuan në përzgjatjen e rënies ekonomike.

Keqësimi i kushteve ekonomike gjatë vitit 2001, i kombinuar me faktorët që përkohësisht rritën normat e inflacionit në fillim të vitit, paraqiti probleme për zbatimin e politikës monetare në eurozonë. Pavarësisht nga kjo, viti 2001 u mbyll me perspektivën e sjelljes së inflacionit në përputhje me përkufizimin e stabilitetit të çmimeve të Bankës Qendrore Europiane, një rritje vjetore të normës së inflacionit nën 2 përqind dhe një e ardhme pozitive që sugjeron mbizotërimin e stabilitetit të çmimeve në një periudhë afatmesme.

2. AMBJENTI BANKAR

2.1. Karakteristikat e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2001

Ekonomia shqiptare, megjithë situatat e vështira që kaloi, për shkak të krizës energjitike, arriti të ruajë ritmet e rritjes në sektorët më të rëndësishëm të saj dhe një ekuilibër në treguesit kryesorë makroekonomikë.

Rritja e prodhimit në fund të vitit u vlerësua në masën 6.5 për qind, pothuajse e barabartë me atë të programuar, një element i rëndësishëm për të çuar përpara ekonominë. Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje i dedikohet gjysmës së parë të vitit, mbasi në gjysmën e dytë të vitit pati frenim të përgjithshëm të aktivitetit ekonomik, i cili ishte pasojë direkte e mungesave të theksuara me energji elektrike.

Karakteristikë e ekonomisë shqiptare edhe këtë vit ishte:

Së pari: zgjerimi dhe forcimi i ekonomisë private, kundrejt tkurrjes dhe pasivitetit të sektorit shtetëror të ekonomisë.

Së dyti: gjallërimi i disa sektorëve të ekonomisë, si transporti, shërbimet dhe investimet, kryesisht në infrastrukturë.

Së treti: rënia e ndikimit të degëve të tilla të rëndësishme si ndërtimi dhe bujqësia, të cilat patën ndikimin kryesor një vit më parë në PBB, por që këtë vit kanë ndikuar më pak.

Së katërti: prodhimi industrial i sektorit shtetëror, kryesisht ai i minierave, vijoi tendencën në rënie si dhe vitet e kaluara, sidomos drastike paraqitej rënia e prodhimit të energjisë elektrike, krahasuar me një vit më parë.

Së pesti: rritja e investimeve shtetërore, kryesisht në degë të tilla si infrastruktura, e cila u pasqyrua në rritje të aktiviteteve të transportit, si dhe në ndërtim dhe në riparim rrugësh.

Edhe këtë vit efektet sezonale kanë patur ndikimin e tyre pozitiv apo negativ mbi ekonominë shqiptare.

Tregu i punës është karakterizuar nga ndryshime në strukturën e tij, që kanë ardhur nga një sërë faktorësh si thellimi i procesit të privatizimit, lëvizja e lirë e popullsisë, duke ndryshuar raportin midis popullsisë urbane dhe rurale, ulja e numrit mesatar të antarëve të familjes, emigracioni etj.

Ndërsa zhvillimet në sektorin fiskal paraqiten të mira, duke shënuar një ulje të deficitit buxhetor krahasimisht me atë të planifikuar. Treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve janë realizuar brenda parashikimeve të hartuara në planin e buxhetit, por ritmika e tyre s'ka qenë e njëjtë. Ndërsa të ardhurat janë realizuar sistematikisht, shpenzimet janë përqendruar kryesisht në dy periudha, në qershor dhe në dhjetor.

Në krahasim me periudhat vjetore të kaluara, niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve ka ardhur duke u rritur, ndërkohë që po mbahet ekuilibër në deficitin buxhetor.

Pozitive ishte dhe mbajtja e inflacionit brenda limiteve të planifikuara, norma vjetore e inflacionit arriti në 3.5 për qind. Megjithatë duhet të theksojmë se tendenca e inflacionit paraqitet në rritje në krahasim me një vit më parë. Kjo për faktin e disa ngjarjeve të rëndësishme që ndodhën brenda dhe jashtë vendit vitin e kaluar. Efekti i këtyre ndikimeve ishte dhe zbehja dhe sfazimi në kohë i ndikimive sezonale në nivelin e inflacionit.

2.2. Ndryshimet ligjore që ndikojnë në aktivitetin bankar

Në maj të vitit 2000 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave". Ky ligj hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2000. Ndër subjektet që i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji janë edhe bankat, zyrat e këmbimeve valutore si dhe subjektet financiare jobanka, që licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë.

Ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", përcakton detyrimin e bankave për të penguar fshehjen, konvertimin ose transferimin e parave apo të pasurisë, kur banka ka dijeni se ato burojnë nga një veprimtari kriminale.

Në zbatim të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave", u krijua "autoriteti përgjegjës" i luftës kundër pastrimit të parave, që është Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, pranë Ministrisë së Financave. Krijimi i këtij autoriteti solli plotësimin e ciklit të veprimeve që kryhen për parandalimin e pastrimit të parave në subjektet financiare. Ky cikël përfshin identifikimin, evidentimin, raportimin, investigimin, bllokimin deri në procedimin penal. Bankat dhe subjektet e tjera të ligjit kryejnë procedurat e identifikimit dhe të raportimit tek autoriteti përgjegjës. Autoriteti mbyll ciklin, duke realizuar grumbullimin e raporteve, verifikimet përkatëse, gjobit subjektet, pezullon veprimet e dyshimta dhe merr masa verifikuese. "Autoriteti përgjegjës", pasi ka vlerësuar dhe ka grumbulluar fakte të mjaftueshme për ekzistencën e veprës penale, bën kallëzimin në organin e prokurorisë.

Gjatë vitit 2001 u miratua ligji i ri, nr. 8782, datë 03.05.01 "Për shoqëritë e kursim - kredive", i cili është një variant i përmirësuar i ligjit të mëparshëm. Përmirësimet kryesore kishin të bënin me përcaktimin më të qartë të pozicionit të Bankës së Shqipërisë, si autoritet mbikëqyrës dhe të pozicionit të unionit të shoqërive të kursim-kreditit, në lidhje me asistencën teknike, me financimin dhe me mbikëqyrjen e anëtarëve të tij. Gjatë vitit 2001, numri i shoqërive të kursim - kreditit të krijuara arriti në 100, me një tendencë për rritje të mëtejshme të tyre, si në zonat rurale ashtu dhe në zonat urbane. Banka e Shqipërisë është në procesin e përfundimit të dy projektrregulloreve të rëndësishme: "Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre" dhe "Për normat e mbikëqyrjes të shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre".

Disa elemente të Basel II

Hyrje: Bazel I - Marrëveshja e kapitalit e vitit 1988.
Marrëveshja e kapitalit e vitit 1988 hartuar nga Komiteti i Bazelit për mbikëqyrjen bankare, hodhi bazat e harmonizimit ndërkombëtar të normave mbikëqyrëse. Në thelb të saj qëndron vendosja e normës minimale të kapitalit për mbulimin e rrezikut të kredisë. Norma bazë e mjaftueshmërisë së kapitalit u përcaktua 8 përqind dhe llogaritet si raport i kapitalit me shumën e aktiveve të ponderuara me rrezikun.
Ndikimi i kësaj marrëveshjeje ishte i menjëhershëm. Fillimisht ajo iu drejtua bankave që ishin aktive në biznesin ndërkombëtar, mjaft shpejt u kthye në një standard për vlerësimin e kapitalit për të gjitha bankat në botë. Kjo marrëveshje qëndron edhe në bazë të normave dhe metodologjisë mbikëqyrëse që Banka e Shqipërisë përdor për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit.
Rritja e kompleksitetit të veprimtarisë bankare dhe rritja e aktivitetit të tregtimit të letrave me vlerë nga ana e bankave, bëri të mundur amendimin e marrëveshjes së kapitalit në vitin 1996, duke përfshirë në të edhe kërkesat për kapital për të mbuluar rreziqet e tregut.
Megjithë përparësitë dhe anët pozitive që paraqet marrëveshja e vitit 1988, ka pasur kritika të mëdha, sidomos këto vitet e fundit. Baza e kritikave qëndron në:

- përcaktimin në mënyrë të përafërt, madje dhe të pasaktë, të rrezikut të institucioneve të kreditit;
- marrëveshja, në llogaritjen e kërkesave për kapital, pothuajse injoron instrumente financiare si derivativet e kreditit, marrëveshjet kompesuese për pozicionet në bilanc, përdorimin global të kolateraleve si dhe të metodave shkencore të vlerësimit të rrezikut të kredisë;
- marrëveshja bazohet në përcaktimin e kërkesave për kapital, duke u kufizuar vetëm në rrezikun e kreditit dhe në atë të tregut, të cilët nuk janë të vetmet rreziqe që bankat ndeshin në aktivitetin e tyre.

BAZEL II
Në dritën e kritikave të cituara më sipër, Komiteti i Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare rishikoi Marrëveshjen e vitit 1988 mbi kapitalin. Objektivi i këtij rishikimi ishte *eliminimi i pikave të dobëta të matjes së rrezikut të kreditit për efekt të llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit, duke përdorur në vend të tyre metoda shkencore në përputhje me konceptet moderne, që tashmë institucionet e kreditit po përdorin për matjen dhe menaxhimin e rrezikut.* Në qershor të vitit 1999, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare publikoi dokumentin e parë konsultativ mbi rishikimin e marrëveshjes së kapitalit. Kjo u shoqërua me publikimin e një dokumenti të dytë konsultativ. Pas thithjes së mendimeve të specialistëve bankarë dhe të autoriteteve mbikëqyrëse në vende të ndryshme, Bazel II mori formën e tij përfundimtare. Fillimisht i përcaktuar për të hyrë në fuqi në vitin 2004, por, si pasojë e debateve të ndryshme është shtyrë për në vitin 2005.
Marrëveshja e re e kapitalit (Bazel II) bazohet në tre shtylla kryesore:

Shtylla I. Norma minimale e mjaftueshmërisë së kapitalit.
Shtylla II. Vlerësimi i procesit mbikëqyrës.
Shtylla III. Transparenca cilësore.

Shtylla I. Norma minimale e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas Bazel II, matet si dhe më parë, e përcaktuar të jetë jo më e vogël se 8 përqind. Marrëveshja e re përveç rrezikut të kreditit dhe rreziqeve të tregut, në përcaktimin e normës së mjaftueshmërisë, merr në konsideratë edhe rrezikun operacional.
Rreziku operacional përcaktohet si rreziku i humbjeve direkte dhe indirekte që rrjedhin nga pamjaftueshmëria ose nga dështimi i proceseve e procedurave të brendshme, i njerëzve, i sistemeve apo nga efekti i ngarjeve të jashtme. Me rritjen e përdorimit të teknologjive moderne të përpunimit të informacionit dhe bankingut elektronik, prania e rrezikut operacional në banka bëhet më e ndjeshme.
Marrëveshja e Bazel II, bazohet mbi tre modele për matjen e rrezikut operacional, të cilat mjaft shkurt mund të përmblidhen në:

a) *Modeli i treguesve bazë;* modeli më i thjeshtë i cili bazohet në tregues mjaft të përgjithshëm dhe bazë siç janë për shembull, të ardhurat bruto të bankës.
b) *Modeli standard*; i cili bazohet në tregues që përfshijnë volumin e transaksioneve bankare për linjë biznesi;
c) *Modeli i brendshëm;* i cili bazohet në historikun statistikor të humbjeve të bankës me natyrë operacionale. Kërkesat për kapital për mbulimin e rrezikut operacional përcaktohen duke shumëzuar këto humbje me një faktor i cili caktohet nga mbikëqyrësit.

Shtylla II. Vlerësimi i procesit mbikëqyrës përbën një nga përmirësimet më të spikatura të marrëveshjes dhe bazohet në:

- përmirësimet e vazhdueshme të modeleve të brendshme të përdorura prej bankave për përcaktimin e profilit të rrezikut dhe të kërkesave për kapital;
- marrjen në konsideratë për përcaktimin e kërkesave për kapital nga bankat dhe nga mbikëqyrësit të faktorëve të jashtëm që lidhen me ciklet e biznesit, si dhe të faktorëve të tjerë (rreziku i normave të interesit, gabimet statistikore të rrezikut operacional etj.);
- dialogun midis bankave dhe mbikëqyrësve mbi modelet e ndërtuara nga vetë bankat për monitorimin dhe matjen e rreziqeve të natyrës bankare;
- aftësinë e mbikëqyrësve për të argumentuar, për të identifikuar dhe për të vendosur norma më të larta se ato minimale për institucione të veçanta.

Shtylla III. Transparenca cilësore mbështetet në parimin se operatorët e mirëinformuar të një tregu do të çmojnë më shumë ato institucione krediti me profil rreziku të mirëmenaxhuar sesa ato institucione që marrin përsipër më tepër rreziqe

3. FUNKSIONET E MBIKËQYRJES BANKARE

3.*1* *Analiza e sistemit bankar*

Gjatë vitit 2001,sistemi bankar shfaqet me anët e tij të forta dhe të dobëta. Një analizë SWOT (strength,weaknesses,opportunites,threats) nxjerr në pahanët e forta,dobësite, shanset dhe kërcenimet :

Pikat e forta:

- Sistemi bankar shqiptar i favorizuar nga një situatë makroekonomike e qëndrueshme dhe në përmirësim të vazhdueshëm mbart në vetvete potenciale zhvillimi.
- Rrjeti bankar po zgjerohet gjithnjë e më shumë në formën e degëve, të agjencive, të zyrave të shërbimit bankar etj..
- Përmirësimi dhe shtrirja e teknologjisë së shërbimeve bankare.
- Struktura e sistemit bankar paraqitet në favor të kapitalit privat dhe sidomos të atij të huaj (proçesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve).
- Kapitalizimi i sistemit bankar paraqitet në nivele të kënaqshme.
- Hyrja e institucioneve të tjera financiare në treg (institucionet jobanka dhe institucionet e mikrokredisë).
- Rezultati financiar i sistemit paraqitet pozitiv duke na dhënë imazhin e një sistemi efikas.
- Kreditimi i vazhdueshëm i klientelës nga bankat e sistemit dhe ruajtja e cilësisë së portofolit të kredive.
- Likuiditeti paraqitet në nivele të kënaqshme për aq kohë sa aktivet e sistemit do të jenë të përqëndruara në bonot e thesarit dhe në kredidhënie afatshkurtër.

Pikat e dobëta:

- Sistemi vuan nga mungesa e një sistemi të zhvilluar pagesash.
- Konkurrenca është akoma e dobët dhe bankat prezantohen akoma joagresive në treg (të ngadalta në shtrirjen në aktivitete me rrezik dhe në prezantimin e një game më të gjerë produktesh).
- Dominimi i një banke në sistem dobëson akoma më tepër konkurrencën.
- Mungon një treg ndërbankar i zhvilluar.
- Mungojnë politika të mirëzhvilluara të kredidhënies dhe plane strategjike zhvillimi të vetë bankave të sistemit.
- Ka shmangie të disa bankave nga planbizneset e tyre.
- Mungon një kuadër ligjor efiçient në vend, që jep ndikimin e vet edhe në sistem.
- Bankat vazhdojnë të ndjehen të sigurta në vendosjet pranë bankave të huaja dhe investimet në bono thesari, duke mos u shtrirë shumë në aktivitetin e kredidhënies.
- Zhvillimi ekonomik i vendit nuk dikton akoma nevojën për hapjen e bankave të specializuara, të investimit, të zhvillimit, apo të atyre kooperativë.

Shanset:

- Stabiliteti makroekeonomik në vend.
- Prania e kapitalit të huaj në sistemin bankar sjell kultura të reja në administrimin e bankave si dhe ka rëndësinë e saj për vetë konceptet e reja dhe praktikat që këto banka të huaja prezantojnë.
- Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në nivele të larta i jep mundësi bankave të rrisin kthyeshmërinë nga aktivet në të ardhmen.
- Konkurrenca midis bankave të sistemit në fillesat e saj do t'i japë shtysë bankave në perspektivën e tyre nga njëra anë për zgjerimin e aktivitetit, për rritjen e shërbimeve bankare, për përmirësimin e cilësisë së tyre dhe, në anën tjetër, për gjetjen e rrugëve të mundshme të uljes së kostos.

Kërcënimet:

- Rreziku i vendit, ekonomik dhe politik.
- Rritja e shpejtë e kërkesave të publikut për kredi (sidomos afatgjatë).

3.1.1 Struktura e sistemit bankar

Sistemi bankar shqiptar vazhdon të mbetet segmenti më i madh dhe më i zhvilluar i tregut financiar në vend. Pavarësisht peshës së vogël që zë pjesa tjetër e sektorit të shërbimit financiar të rregulluar me ligj[1], ajo njeh ritme rritjeje gjatë vitit 2001. Në perspektivë kjo pjesë do të mund të pozicionohet më mirë ndaj sistemit bankar dhe për rrjedhojë do të rrisë dhe ndikimin e saj në stabilitetin e përgjithshëm të tregut financiar. Sistemi bankar nuk evidenton ndryshime strukturore gjatë vitit 2001. Në përbërjen e tij vazhdojnë të renditen 13 banka - 1 bankë me kapital shtetëror (banka më e madhe e sistemit), 2 banka me kapital të përbashkët dhe 10 banka me kapital privat (përfshirë 3 degë të bankave të huaja).

Grafik 1. Struktura e sistemit bankar sipas pronësisë së kapitalit.



Bankat e kanë përqëndruar aktivitetin e tyre në Tiranë, ndonëse gjatë këtij viti shihet një zgjerim i rrjetit në formën e degëve dhe të agjencive në rrethe të tjera të vendit nga bankat private (Banka Tirana, Banka Alfa, Banka Fefad etj.).

Tabelë 1. Shpërndarja gjeografike e sistemit bankar në fund të vitit 2001.

Nr	Emri i bankës	Numri i punonjësve gjithsej	Numri i degëve	Rrethi ku është hapur	Numri i agjencive	Rrethi
1.	BKT	271	10	Tiranë 1, Tirana 2, Tirana 3, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Vlorë, Lushnjë, Gjirokastër	1	Durrës

[1] Të tilla si institucionet jobanka, zyrat e këmbimit valutor, shoqëritë e kursim kreditit, kompanitë e sigurimit, fondet e investimeve etj..

2.	BK	1674	38	Berat,Kuçovë,Çorovodë, Bilisht, Burrel, Durrës 1, Durrës 2, Elbasan, Gramsh,Peqin,Fier,Ballsh, Gjirokastër, Tepelenë, Kavajë, Korçë, Ersekë, Krujë, Kukës, Krum,Laç,Rrëshen, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Përmet, Peshkopi, Bulqizë,Pogradec, Sarandë, Delvinë,Shkodër, Koplik,Pukë,Bajram Curri, Tiranë 1, Tiranë 2, Vlorë	71 agjenci kursimi 60 zyra bankare	
3.	BISH	63			2	Tiranë, Durrës
4.	BASHI	42	1	Shkodër		
5.	BD	12				
6.	BT	124	5	Tiranë, Durrës, Fier, Gjirokastër, Korçë		
	BKG-dega	61			3	Durrës Korçë, Tiranë
7.	BTN	32	1	Tiranë		
8.	BA-dega	42	4	Tiranë, Durrës, Elbasan, Gjir		
9.	BASH	107	1	Durrës	16	
10.	FEFAD	135	6	Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër	62	Tiranë
11.	BPI-dega	13				
12.	BTG(AL)	32				

3.1.2 Aktivet e sistemit, struktura dhe cilësia e tyre

Sistemi bankar i favorizuar nga mjedisi ekonomik reflektoi një pamje të shëndoshë edhe gjatë vitit 2001. Analiza sasiore dhe cilësore e aktiveve të sistemit evidenton tendencën në rritje të tyre, një diversifikim jo shumë të konsiderueshëm të strukturës, si dhe një nivel në përmirësim të cilësisë së portofolit të kredisë.

Totali i aktiveve të sistemit bankar, në krahasim me fundivitin 2000, u rrit 17.6 përqind. Aktivet e sistemit zënë rreth 53.5 përqind të PBB të vendit, gjë që dëshmon për një vend të konsiderueshëm të sistemit bankar në ekonomi.

Tabelë 2. PBB dhe totali i aktiveve.

Vitet		PBB		Totali i aseteve te SB	
	Në milionë Lekë*	% e rritjes	Në milionë euro/ECU**	Në milionë Lekë	në % ndaj PBB
1	2	3	4	5	6
1996	280,998	9.1	2,148	128,714.0	45.8
1997	341,716	-7.0	2,034	167,309.5	49.0
1998	460,631	8.0	2,736	206,031.7	44.7
1999	506,205	7.3	3,445	249,484.6	49.2
2000	539,210	7.8	4,067	270,834.2	50.2

2001	590,200	6,5	4,594	318,456.9	53.9

*PBB me çmime korente. **Janë marrë për bazë kurset mesatare vjetore.

Peshën kryesore në aktivet e sistemit vazhdon ta ketë Banka e Kursimeve, pavarësisht kontributit në rritje të bankave private në sistem.

Tabelë 3. Pesha e çdo grupi ndaj sistemit bankar (në %).

Vitet	G1	G2	G3	Sistemi bankar
1999	81.4	5.8	12.8	100.0
2000	64.8	6.2	29.0	100.0
2001	59.2	5.8	35.0	100.0

Banka e Kursimeve, si përfaqësuese e vetëme e grupit të bankave shtetërore, megjithëse vazhdon të dominojë në tregun e grumbullimit të depozitave, po konkurohet nga bankat private, të cilat po rrisin në mënyrë të ndjeshme peshën e tyre në treg, duke u shtrirë më shumë në aktive me rrezik dhe më fitimprurëse. Kështu, përkundrejt bankës më të madhe të sistemit, janë bankat private që po investojnë gati trefishin e aktiveve me rrezik të kësaj banke.

Struktura e zërave kryesorë të aktiveve paraqet një diversifikim jo shumë të konsiderueshëm. Investimet në bono thesari megjithëse kanë ulur lehtë peshën e tyre në aktivet e sistemit përsëri vazhdojnë të zënë peshën kryesore. Bankat vazhdojnë të ndjehen më të sigurta në këtë lloj investimi, në vendosjet pranë bankave jorezidente dhe më pak të sigurta në kredidhënie e letra të tjera me vlerë.

Analiza e strukturës për grup bankash evidenton diversifikime më të ndjeshme të strukturës në grupin e bankave private (26.4% - bono thesari; 26.7% - vendosje pranë bankave jorezidente, 18.1% - kredidhënie dhe 9.5% letra të tjera me vlerë) dhe të atyre me kapital të përbashkët (33.8% - vendosje pranë bankave dhe 33.4% - kredidhënie). Ndërkohë është Banka e Kursimeve me përqendrimin më të madh (rreth 71% të aktiveve) në investimet në bono thesari dhe që jep edhe shtrembërime të strukturës së sistemit në tërësi.

Grafik 2. Struktura e aktiveve të sistemit bankar.



Analiza e **cilësisë së aktiveve** përbën një parakusht të rëndësishëm të mbikëqyrjes bankare për të siguruar stabilitet të sistemit bankar në vend. Kur flasim për cilësi të aktiveve, marrim në konsideratë portofolin e kredive dhe atë të letrave me vlerë. Sa më likuidë, të mbrojtur e të diversifikuar të jenë këto portofole, aq më e lartë është edhe cilësia e aktiveve. Treguesit e cilësisë së aktiveve marrin në konsideratë edhe zërat jashtë bilancit si detyrime potenciale të bankave, por në sistemin tonë bankar zërat jashtë bilancit përfaqësojnë një peshë të vogël ndaj totalit të aktiveve (rreth 3.4%) dhe janë kryesisht angazhime dhe garanci.

Së pari, do të trajtojmë ecurinë e kreditimit të klientelës dhe ***së dyti***, treguesit e cilësisë.

Teprica (neto) e kredisë është rritur rreth 65 për qind (ose 10.6 miliardë lekë) në krahasim me fundvitin 2000. Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë bankat private të cilat kanë zgjeruar shumë kredidhënien sidomos në periudhën e dytë të vitit.

Grafik 3. Kreditimi i klientelës (në milionë lekë).



Por, aspekti më i rëndësishëm, që fokuson drejpërdrejt mbikëqyrja bankare në portofolin e kredive, është cilësia e tij. Portofoli i kredive shpesh është aktivi më i madh dhe burimi kryesor i të ardhurave. Por, në të njëjtën kohë ai është dhe burimi kryesor i rreziqeve[2] me të cilat ndeshet sistemi. Problemet e portofoleve të kredive kanë qenë shpesh shkaqet kryesore të humbjeve dhe të dështimeve të bankave – të cilat kanë gjetur shpjegim në standardet e dobëta krediduese, në politikat joprudente të provigjonimit, në menaxhimin e varfër të rrezikut të portofolit ose, në dobësitë e ekonomise.

Treguesi kryesor që flet për cilësinë e portofolit të kredive, është raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë (bruto). Nga 42.4 për qind dhe 39.9 për qind që rezultonte ky tregues respektivisht në fundvitin 2000 dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2001, në fund të këtij viti treguesi rezulton në një nivel mjaft të kënaqshëm prej 6.9 për

[2] Fjala "rrezik", e cila do të shfaqet vazhdimisht në analizë, ka të bëjë me mundësinë që ngjarjet e pritura ose të paparashikuara të kenë një ndikim jo të favorshëm në kapitalin apo në të ardhurat e bankave.

qind. Efektin kryesor në përmirësimin e këtij treguesi për sistemin e jep ulja e nivelit të kredive me probleme të Bankës së Kursimeve në gjashtëmujorin e dytë të vitit me kalimin e pjesës më të madhe të tyre pranë ATK-së. Kështu, nga 90.8 për qind që rezultonte ky tregues në fund të gjashtëmujorit të parë, vetëm për Bankën e Kursimeve, në këtë fundvit ai rezulton 7.3 për qind.

Në vijim të analizës së cilësisë së portofolit të kredisë, duke marrë në konsideratë treguesin e kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë (neto), ne do të mund të gjykojmë se sa i ekspozuar është sistemi ndaj *rrezikut të kreditit.*

Ky tregues për sistemin bankar në fundvit rezulton 4 për qind dhe flet për *një ekspozim të kufizuar ndaj rrezikut të kreditit*.
Por, megjithë ekspozimin jo të konsiderueshëm ndaj rrezikut të kreditit, lind pyetja: Sa i aftë është sistemi ynë që të përballojë këto humbje që rrjedhin nga kredia ?

Duke parë nivelet e kapitalit të bankave si dhe vlerën e raportit të kredive me probleme neto ndaj kapitalit aksioner (5.8%), gjykojmë për një mbulim të mirë me kapital të humbjeve të mundshme nga kredia. Këtë evidentim e mbështet edhe vlera prej 6.7 për qind e kredisë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator, e cila paraqitet më e favorshme për grupin e bankave private (2.3%).

Një aspekt tjetër, që mund të sinjalizojë dobësi të konsiderueshme në sistemin bankar është edhe *mungesa e diversifikimit të portofolit të kredisë*. Kështu, degët më të favorizuara nga sistemi me kredi janë tregtia (41.3% ndaj tepricës së kredisë), industria përpunuese (19.5%) dhe ndërtimi (12.5%). Përqëndrimi i kredidhënies, kryesisht në tre degë të ekonomisë, *i ekspozon bankat e sistemit ndaj vështirësive të një sektori apo të një aktiviteti ekonomik.*

Po kështu, edhe përqëndrimi i kredisë në një numër të vogël kredimarrësish e rrit *ekspozimin e bankave të sistemit ndaj rrezikut të kreditit.* Bankat, megjithëse evidentojnë përqëndrime potenciale në disa kredimarrës, këto të fundit janë të garantuara me kolateral dhe nuk i ekspozojnë bankat ndaj riskut në këtë lloj përqendrimi[3].

Sistemi ka krijuar, gjithashtu, fondet përkatëse për mbulimin e humbjeve nga kreditë (rreth 864 milionë lekë). Fondet e krijuara nga bankat mbulojnë rreth 44 për qind të kredive me probleme. Për aq kohë sa bankat përmbushin kërkesat rregullatore të provigjonimit, *niveli i ulët i këtij raporti flet për një nivel të ulët të kredive të humbura* (norma e provigjonimit për këtë kategori është 100%).

3.1.3 Ecuria e depozitave dhe e llogarive rrjedhëse.

Burimet nga të tretët, si burim kryesor i fondeve bazë të bankave tregtare, zënë rreth 86.1 për qind të totalit të pasiveve.

Në këtë fundvit burimet nga të tretët u rritën rreth 20 për qind në krahasim me fundvitin 2000. Kontributin kryesor në këtë rritje e japin bankat private, ndonëse depozitat e sistemit janë të përqendruara në Banken e Kursimeve megjithëse me një tendencë në rënie.

[3] Në fundvit evidentohen dy banka (Banka e Kursimeve dhe Banka Kombetare Greke) të cilat shkelin normativën për rreziqet e mëdha dhe këto vetëm për vendosjet pranë bankave jorezidente.

Tabelë 4. Ecuria e aktivitetit depozitues të Bankës së Kursimeve në sistemin bankar.

Treguesi në % ndaj sistemit bankar	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Qershor '01	Dhjetor '01
Depozita të pranuara	74.6	69.3	66.0	63.7

Një vështrim në strukturën e depozitave të sistemit, evidenton nivelin më të lartë të depozitave në lekë (67%), me afat (78%) dhe të pranuara nga individët (84%) në totalin e depozitave të sistemit. Kështu, ndërsa dy të fundit ruajnë tendencën e tyre rritëse, për depozitat në lekë vihet re një ulje e lehtë[4], që favorizon tendencën rritëse të depozitave në valutë, të cilat ndonëse mbartin një normë interesi të ulët, përsëri kanë qënë të preferuara nga publiku.

Grafik 3. Struktura e depozitave të sistemit.

Grafik 3.a Sipas sektorëve.



Grafik 3.b Sipas monedhave.



[4] Megjithëse Banka e Shqiperisë rriti normën e interesit për repot në gjashtëmujorin e dytë të vitit, bankat e sistemit janë treguar shumë pasive në rritjen e interesave për depozitat.

Grafik 3.c Sipas afateve.



3.1.4 Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve të sistemit, rezultati financiar

Sistemi bankar, për të tretin vit rradhazi, evidenton rezultat financiar pozitiv (fitim) **prej 4,3 miliardë lekësh** (kundrejt 5,3 miliardë lekëve në fundvitin 2000 dhe 1,2 miliardë lekëve në fundvitin 1999). Në këtë tregues ndikimin kryesor e jep Banka e Kursimeve (fitim për 3 miliardë lekë) si dhe kontributi në rritje i fitimit të rezultuar në bankat private.

Një vështrim në strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve të sistemit bankar evidenton burimin kryesor të të ardhurave të sistemit, të ardhurat neto nga interesat. Këto të ardhura rezultojnë 8,7 miliardë lekë kundrejt 7,7 miliardë lekëve në fundvitin 2000 (ose 12.1% rritje).

Të ardhurat nga interesat përfaqësojnë 76.7 për qind të të ardhurave financiare. Ndonëse vazhdojnë të jenë burimi kryesor i të ardhurave, në këtë fundvit paraqesin tendencë rënieje krahasuar me një vit më parë për rreth 1 miliardë lekë (ose 4.4 %). Ndikimin kryesor në këtë rënie e jep rënia e të ardhurave nga bonot e thesarit (për rreth 1,3 miliardë lekë).

E njëjta dukuri evidentohet edhe për shpenzimet financiare. Rreth 55,1 për qind e shpenzimeve financiare shkojnë për pagimin e interesave të klientëve. Shpenzimet për interesa evidentojnë një rënie rreth 2 miliardë lekë (ose 12.5%) në krahasim me fundvitin 2000.

Megjithë tendencën në rënie të këtyre dy treguesve, rezultati neto nga interesat evidentohet më i lartë krahasuar me vitin 2000. Kjo nxjerr në pah faktin që sistemi ka përballuar një kosto depozitash më të ulët.

Tabelë 5. Ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesat.

Treguesi milionë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01
Të ardhurat nga interesat	25 808.7	23 441.2	22 410.8
Shpenzime për interesa	20 635.0	15 701.3	13 732.5
Rezultati neto	5 173.7	7 739.9	8 678.3

Ndikim pozitiv në rezultatin financiar të sistemit bankar ka dhënë edhe rezultati neto nga veprimtaritë e tjera, i cili rezulton pozitiv për rreth 2,4 miliardë lekë kundrejt 2,2 miliardë lekëve që rezultonte në fundvitin 2000. Kontributin kryesor në këto të ardhura e japin të ardhurat neto nga komisionet dhe nga veprimtaria valutore.

Grafik 4. Struktura e të ardhurave



Shpenzimet që japin ndikimin kryesor në uljen e rezultatit neto nga veprimtaria kryesore e sistemit bankar janë: *a) shpenzimet për provigjone; dhe b) shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë.*

Gjatë vitit 2001, shpenzimet financiare janë rënduar në masën 679,8 milionë lekë për *krijimin e fondeve rezervë* për mbulimin e humbjeve nga huatë. Këto shpenzime përbëjne 6.6 për qind të të ardhurave bruto të veprimtarisë dhe rreth 79.5 për qind të tyre i takojnë grupit të bankave me kapital të përbashkët.

Grafik 5. Struktura e shpenzimeve.



Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë rezultojnë rreth 4,8 miliardë lekë, ose 0,8 miliardë lekë më të larta në krahasim me fundvitin 2000 dhe përbëjnë rreth 19.3 për qind të shpenzimeve financiare (kryesisht shpenzime personeli dhe shpenzime të tjera). Rritja në shpenzimet e veprimtarisë i dedikohet zgjerimit të rrjetit bankar – hapjes së degëve dhe agjencive të reja bankare - si dhe përmirësimeve dhe rritjes së nivelit të teknologjisë dhe informacionit etj..

Treguesit e rentabilitetit në fund të vitit 2001 rezultojnë ROA 1.5 për qind dhe ROE 21.6 për qind. Në rënien e ROA ka ndikuar rënia e lehtë e rezultatit neto dhe rritja e aktiveve mesatare (14.8%). *Të dy treguesit vlerësohen në nivele të pranueshme*.

Tabelë 6. Ecuria e treguesve të rentabilitetit.

Treguesi ne %	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01
ROA	0.5	2.1	1.5
ROE	15.7	20.6	21.6

Analiza e marzhit neto të interesave tregon që gjatë tre viteve të fundit ky tregues është pothuajse në nivelin 3 për qind, me luhatje të lehta nga një vit në tjetrin.

Tabelë 7. Marzhi neto nga interesat.

Treguesi në %	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01
Interesa aktive*	15.2	11.6	8.4
Interesa pasive**	12.2	7.8	5.2
Marzhi neto (interesa aktive-interesa pasive)	3.0	3.8	3.3

* të ardhura nga interesi / aktive mesatare që sjellin të ardhura.
** shpenzime për interesa / aktive mesatare që sjellin të ardhura.

Grafik 6. Marzhi neto nga interesat.



Rritja e aktiveve mesatare që sjellin të ardhura (31.6%) në nivele më të larta se pasivet mesatare që shkaktojnë shpenzime (15.6%) do të ndikojë pozitivisht në të ardhurat e ardhshme të sistemit bankar.

Raporti i efikasitetit (shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë / të ardhura bruto të veprimtarisë) rezulton 46.3 për qind në këtë fundvit nga 34.5 për qind që rezultonte në fundvitin 2000. Në disa banka të sistemit, ky tregues evidentohet më i lartë se treguesi agregat për sistemin.

3.1.5 Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, likuiditeti dhe ndjeshmëria ndaj rreziqeve të tregut

Kapitali (fondet e veta) është ndër elementet më të rëndësishme në jetëgjatësinë e një institucioni krediti.

Në tërësinë e rreziqeve ndaj të cilave mund të ekspozohet sistemi, si për shembull rreziku i kreditit, i tregut[5], i likuiditetit, operacional, i reputacionit, ligjor etj., me përjashtim të rrezikut të likuiditetit, pothuaj të gjithë të tjerët monitorohen me madhësinë e kapitalit që zotëron banka.

Treguesi kryesor, që përcakton aftësitë e bankës për të përballuar humbjet e mundshme të saj dhe me rëndësi të veçantë për marrjen e vendimeve, është r*aporti i mjaftueshmërisë së kapitalit*. Norma minimale e këtij të fundit, e zbatueshme në vendin tonë është 12 për qind për çdo bankë, që do të thotë se kapitali rregullator i bankës nuk duhet të bjerë nën 12 për qind të totalit të aktiveve të ponderuara me rrezikun. Ky tregues i llogaritur në mënyrë agregate për tërë sistemin tonë bankar rezulton 35.3 për qind në fundvitin 2001 nga 42 për qind që rezultonte në fundvitin 2000. Rënia është kryesisht rezultat i rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezikun (17.2%), si dhe i rënies së kapitalit rregullator (1.5%).

Megjithëse, konstatohet një shtrirje e sistemit në aktivitete më me rrezik, përsëri lëvizjet në këtë drejtim janë të kufizuara. Ky fakt vertetohet në raportet e larta të mjaftueshmërise së kapitalit të evidentuara për banka të veçanta.

Në qoftë se marrim në konsideratë nivelin e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin tonë bankar krahasuar me atë të disa vendeve të rajonit:

Tabelë 8. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (Dhjetor 2001).

Shteti	Treguesi në %
Moldavi	40
Shqipëri	35.3
Bosnje-Hercegovinë	32
Rumani *	23.7
Kroaci *	21.3

* - Dhjetor 2000

Vihet re e njëjta situatë në Moldavi si dhe në Shqipëri - *bankat preferojnë të investojnë kryesisht në letra me vlerë të qeverisë dhe vendosje pranë bankave.* Ndërkohë, për shtetet e tjera në listë, evidentohen nivele më të ulta të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Kështu, s*istemi ynë bankar paraqitet i kapitalizuar për vetë shtrirjen e kufizuar të bankave në aktivitete me rrezik, që do të thotë një nivel i mjaftueshëm kapitali për mbulimin e rrezikut ndaj të cilit ekspozohet sistemi ynë bankar. Bankat që operojnë në*

[5] Ky rrezik përbëhet nga rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i çmimit të kapitalit (aksioneve) dhe rreziku i "mallrave" të tjerë.

Shqipëri vazhdojnë të mos jenë shumë aktive në kreditimin e ekonomisë, dhe në përmbushjen e nevojave të komunitetit në përgjithësi.

Likuiditeti është treguesi i aftësisë së një institucioni krediti për të financuar rritjet e aktiveve dhe për të përmbushur në kohë detyrimet e tij. Mungesa e likuiditetit të një banke të vetme mund të japë ndikim mbi tërë funksionimin efiçent të sistemeve të pagesave të sitemit, dhe për rrjedhojë edhe mbi stabilitetin e sistemit.

Si tregues kryesorë të likuiditetit, në analizë ne marrim në konsideratë raportin e likuiditetit dhe metodën e *gap*-it të maturimit.

Bankat e sistemit relatojnë një peshë të madhe të aktiveve likuide në totalin e aktiveve të tyre dhe për rrjedhojë dhe *një raport të lartë likuiditeti* (aktive likuide / pasive likuide)[6] mbi 100 për qind.

Gap-i i maturimit deri në 1 muaj (diferenca midis aktiveve me pasivet me maturim të mbetur deri në një muaj), rezulton pozitiv për pjesën më të madhe të bankave në fundvitin 2001. Ndërkohë, edhe bankat që evidentojnë vlera negative të këtij *gap*-i, në shumë absolute zënë një pjesë të vogël të totalit të aktiveve.

Sistemi bankar në Shqipëri përbëhet nga banka likuide, të cilat arrijnë t'i përmbushin në kohë detyrimet e tyre. Por, krahas kësaj është edhe Banka e Shqipërisë, e cila në përmbushjen e funksioneve të saj ka krijuar dhe krijon një sërë lehtësirash për bankat si për thithjen e tepricave të likuiditetit ashtu dhe për plotësimin e nevojave për këtë të fundit.

Në vazhdim të analizës tonë dhe si një pjesë të rëndësishme të saj, do të trajtojmë shkurtimisht disa **elemente të ndjeshmërisë së sistemit bankar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit dhe normës së interesit.**

Rreziku i kursit të këmbimit, ka të bëjë me ndikimin që mund të ketë ndryshimi i normave të këmbimit në vlerën e aktiveve dhe pasiveve të bankave të sistemit dhe *për rrjedhojë edhe në nivelin e kapitalit*. Madhësia më e përdorur për matjen e ekspozimit ndaj këtij rreziku, ë*shtë pozicioni neto në valutë*. Kështu, në fundvitin 2001, rezulton vetëm Banka e Kursimeve mbi normë për pozicionin e hapur neto për të gjitha monedhat, me vlerën përkatëse prej 38.7 për qind të kapitalit të saj rregullator, ndërsa për pozicionin e hapur neto për një monedhë të veçantë, është po kjo bankë për euron (43%) dhe Banka Kombëtare Tregtare për usd (-21.6%).

Rreziku i normës së interesit shfaqet në ndryshimin e vlerës së aktiveve, apo pasiveve të bankës, të ndjeshme ndaj normës së interesit, me ndryshimin e kësaj norme. Ky rrezik, për bankat që operojnë në Shqipëri, monitorohet nëpërmjet rregullores së: "Risqeve të tregut", e cila mbulon dhe rrezikun e kursit të këmbimit, të përmendur më lart.

Duke u mbështetur në të dhënat për bankat e sistemit të fundvitit 2001, evidentohet një nivel i mjaftueshëm i kapitalit rregullator për çdo bankë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga rreziqet e tregut.

[6] Pasive likuide janë konsideruar: veprimet me thesarin dhe ndërbankare, depozitat pa afat, 10% të llogarive rrjedhëse (90% e llogarive rrjedhëse, sipas standardeve bashkëkohore konsiderohen fonde të veta për bankën, për shkak të natyrës së tyre "të patërheqshme").

Shpesh një madhësi e përdorshme matëse e rrezikut të normës së interesit është edhe ndryshimi në të ardhurat neto nga interesat për shkak të ndryshimit të normës së interesit. Minimizimi i këtij rreziku mund të arrihet me minimizimin e ndryshimit të të ardhurave neto nga interesat. Kështu,

$$\text{ndryshimi në të ardhurat neto nga interesat } (\Delta NII) = GAP*\Delta R \quad (1)$$

Në formulën e mësipërme *gap*-i i përgjigjet diferencës midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, për një afat të caktuar maturimi. Në këtë mënyrë, nëse llogarisim *gap*-in e maturimit deri në 1 muaj për tërë sistemin, ai rezulton 45 401.5 milionë lekë. Në llogaritjen e mësipërme, nga aktivet dhe pasivet me maturim deri në 1 muaj kemi përjashtuar respektivisht mjetet monetare dhe llogaritë rrjedhëse[7], duke arsyetuar se këta zëra nuk janë të ndjeshëm ndaj normës së interesit. Ky *gap* pozitiv deri në 1 muaj e ekspozon sistemin ndaj një rënieje në normat e interesit për instrumentet me afat maturimi deri në një muaj. Edhe sikur rënia të jetë minimale për periudhat e ardhshme (supozojmë 0.1% për instrumentet me afat maturimi deri në 1 muaj), sistemi bankar do të përballej me një rënie në të ardhurat neto nga interesat prej 45.4 [45 401.5*(-0.1%)] milionë lekësh. *Por, aktualisht, normat e ineteresit për lekun kanë tendencë në rritje (është rritur norma bazë e interesit me 0.5 pikë %).* Zakonisht, në formulën (1) aplikohet një *gap* kumulativ me afat më të gjatë maturimi. Kështu, nëse llogarisim *gap*-in kumulativ deri në 3 muaj, për tërë sistemin bankar ai rezulton 224.1[8] milionë lekë. Kjo vlerë e papërfillshme e këtij *gap*-i flet *për një ekspozim të kufizuar të sistemit* ndaj çdo lëvizjeje[9] të normave të interesit për instrumentet me afat të shkurtër.

Në mbyllje do të themi që sistemi bankar shqiptar është në faza të shfaqjes së qëndrueshmërisë së tij dhe ndërmarrjes së riskut të kufizuar. Ai vazhdon të evidentojë edhe në fund të vitit 2001 gjendje financiare relativisht të shëndoshë.

[7] Zakonisht, bankat nuk paguajnë interesa për llogaritë rrjedhëse.
[8] Eshtë ndjekur e njëjta logjikë për llogaritjen e tij, që do të thotë se nga aktivet me maturim deri në 3 muaj janë zbritur mjetet monetare, ndërsa nga pasivet me maturim deri në 3 muaj janë zbritur llogaritë rrjedhëse.
[9] Lëvizja nënkupton si rritjen dhe rënien e normave të interesit.

3.2 Inspektimet në vend dhe masat korrektuese

Inspektimet në vend, si një pjesë e rëndësishme e mbikëqyrjes bankare, edhe për vitin 2001 kanë evoluar, duke shënuar përmirësime si në aspektin global, (duke mbuluar të gjitha bankat e sistemit me inspektime të plota), ashtu edhe në atë cilësor, duke synuar drejt një fizionomie bashkëkohore.

Rritja e cilësisë së inspektimeve është arritur kryesisht nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të inspektorëve, si me seminare të kryera nga specialistë të huaj të fushave të ndryshme, ashtu edhe nëpërmjet seminareve të mbajtura nga inspektorë më me eksperiencë, duke u dhënë përvojën e tyre inspektorëve më të rinj.

Karakteristika të inspektimeve të këtij viti kanë qenë **së pari:** një bashkëpunim më i ngushtë i inspektorëve me drejtues të bankave të nivelit të dytë, për të realizuar objektivat e mbikëqyrjes bankare: forcimin e sistemit bankar, mbrojtjen e të drejtave të depozituesve, sidomos depozituesve të vegjël.

Së dyti: Ndryshimi i perceptimit të programit të inspektimit, duke u orientuar më shumë në inspektimin e fushave, të cilat paraqesin rrezik për bankat, sesa në revizionimin e aktivitetit bankar, duke krijuar një fushë më të specializuar e të ndryshme kontrolli në krahasim me kontrollin e kryer nga kontrollorët e jashtëm. Gjithashtu, ky program për herë të parë u bazua në strategjitë e hartuara për secilën bankë nga inspektorët që i mbulojnë ato, mbi bazën e problemeve që kanë paraqitur bankat në inspektimet e mëparshme apo që kanë dalë nga sistemi i paralajmërimit të hershëm etj.

Së treti: Rritja e efektivitetit të punës, e cila kursen jo vetëm kohën e punës së inspektorëve, por edhe kohën e konsumuar nga bankat për t'iu përgjigjur kërkesave të inspektimeve. Kohëzgjatja e një inspektimi është reduktuar në 2-3 javë.

Së katërti: Rritja e cilësisë së inspektimeve, thellimi në analizën CAMELS, duke përdorur metoda bashkëkohore analize.

Gjatë vitit 2001, u realizuan 13 inspektime të plota dhe 10 të pjesshme (në krahasim me 11 inspektime të plota dhe 5 të pjesshme të realizuara në vitin 2000).

Objektivat më të rëndësishëm të ekzaminimit në bankat e nivelit të dytë, kanë qenë:

(i) Kryerja nga bankat e një veprimtarie të sigurtë e të qëndrueshme.
(ii) Identifikimi i bankave apo i veprimtarive bankare të veçanta, që kërkojnë vëmendjen e autoritetit të mbikëqyrjes.
(iii) Plotësimi, miratimi dhe mbikëqyrja nga këshillat drejtues, i akteve të brendshme të veprimtarisë së bankës si: politika, procedura etj..

Në përgjithësi, gjendja në sistemin bankar, e vlerësuar nga ekzaminimet në vend, paraqitet e mirë, gjë e cila është një element shumë i rëndësishëm për mbështetjen e ekonomisë në zhvillimet e saj.

Disa nga karakteristikat kryesore që u vunë re në sistemin bankar gjatë vitit 2001 janë:

- Një rritje e ndjeshme e aktiveve të disa bankave, gjë që tregon për një afrim më të madh të klientëve dhe për një politikë më agresive nga ana e bankave. Kjo rritje ka ardhur dhe si rezultat i zgjerimit të bankave me degë apo me agjenci të reja.

- Plotësimi nga të gjitha bankat i kapitalit minimal të paguar në shumën 700 milionë lekë. Kjo është një garanci më e madhe për një sistem të shëndoshë bankar, aq më tepër në kushtet e zgjerimit të aktivitetit të tyre. Përgjithësisht, të gjithë aksionerët kanë qenë të gatshëm për plotësimin e kapitalit.

- Ndryshime në strukturën e aktiveve të bilancit në disa banka, ku paraqitet në rritje zëri: "kredi për klientët" që tregon se bankat po fillojnë të dalin nga gjendja vrojtuese dhe pasive, duke u bërë më aktive në rritjen e ekonomisë së vendit. Përgjithësisht, zgjerimi i aktivitetit kreditues është shoqëruar me një përkeqësim të portofolit të kredisë. Kjo ka ardhur nga disa shkaqe, ku do të veçonim si më kryesoret:

  (i) fillimi i aktivitetit kreditues pa siguruar më parë një staf të përgatitur, për t'iu përgjigjur kërkesave të këtij sektori si dhe mungesa e eksperiencës për monitorimin e kredive;

  (ii) mosmbështetja në politika dhe procedura të plota e të sakta;

  (iii) ekzistenca e një tregu jo në nivelin e duhur për t'iu përgjigjur detyrimeve të një kredimarrjeje apo parimeve të ekonomisë së tregut;

  (iv) situata e pastabilizuar në disa sektorë jetikë të ekonomisë, si ai i energjitikës;

  (v) mosfunksionimi i aspekteve ligjore që kanë të bëjnë me procesin e kreditimit.

- Ka patur një gjendje likuiditeti të mirë, përgjithësisht si rezultat i investimit në zëra likuidë si vendosje në bankat e tjera apo bono thesari. Bankat, në përputhje me operacionet, me shërbimet dhe me madhësinë e tyre, kanë patur nën kontroll rreziqet e normave të interesit (pavarësisht se nuk janë shumë të pranishme në ambjentin korent) apo të kursit të këmbimit, duke tentuar në mbajtjen e niveleve sa më të ulta të *gap*-it apo nivele spred-i optimale, dhe duke përmirësuar ndjeshëm në krahasim me një vit më parë administrimin e aktiv-pasiveve. Ka një progres në këtë fushë, duke futur metoda bashkëkohore për përgatitjen e një informacioni sa më të plotë dhe të shpejtë.

- Përgjithësisht, bankat kanë dalë me rezultat pozitiv dhe me fitim në rritje krahasuar me një vit më parë. Kjo, si rezultat i zgjerimit të tyre, i mbulimit të shpenzimeve të hapjes dhe përmirësimit të strukturës së aktiveve të bilancit me investime në zëra më fitimprurës. Trendi i të ardhurave paraqitet i qëndrueshëm.

- Drejtimi i lartë, në përgjithësi, ka reaguar pozitivisht ndaj vërejtjeve të ngritura nga ekzaminimet e kryera, por nuk ka treguar kujdesin e duhur për :

  (i) përmirësimin e politikave dhe të procedurave të aktivitetit të bankës;
  (ii) plotësimin e kuadrit rregullativ të aktivitetit të bankës;

(iii) zbatimin e planbiznesit të bankës.

Gjatë inspektimeve të kryera janë konstatuar gjetje, të cilat nuk janë në përputhje me praktikat e shëndosha bankare. Këto gjetje kanë qenë të natyrave të ndryshme si:

- Shkelje të ligjit për kontabilitetin. Mosmbajtja në monedhën vendase e llogarive të rezultatit financiar, moszbatimi me korrektësi i Manualit të Kontabilitetit Bankar për regjistrimin në zëra jashtë bilancit të garancive të marra në formë pronësie si dhe mosregjistrimi si zëra jashtë bilancit të kufirit të lëvruar e të papërdorur për kreditë me kufi .
- Shkelje të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 20. Në disa banka nuk funksionon komiteti i kontrollit apo njësia e kontrollit të brendshëm.
- Shkelje të kërkesave të ligjit: "Për shoqëritë tregtare", mbi mbajtjen e regjistrit të aksionerëve dhe regjistrimit të ndryshimeve në statut.
- Shkelje të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë si :

  (i) klasifikimi i portofolit të kredive jo në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë";
  (ii) llogaritje jo e saktë e pozicionit të hapur valutor si dhe tejkalim të kësaj norme të parashikuar në rregulloren përkatëse;
  (iii) tejkalim të përqendrimit në një përfitues të vetëm (bankat jorezidente) mbi limitin e lejuar në rregulloren përkatëse;
  (iv) emërimi dhe fillimi nga detyra e administratorëve në disa banka pa marrë më parë miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë;
  (v) dokumentacioni për kryerjen e transfertave nuk i përgjigjet kërkesave të rregullores "Për veprimtarinë valutore".

Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare, në varësi të shkeljeve të evidentuara, ka përcaktuar masat korrektuese ose ndëshkimore, mbështetur në dispozitat e ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Masat korrektuese dhe ndëshkimore që janë zbatuar në vitin 2001 janë:

(i) rekomandime apo sugjerime për të korrigjuar parregullsitë e vogla;
(ii) kërkesa për paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të një programi masash për rregullimin e gjendjes së bankës, në rast të ndeshjes së parregullsive, duke përcaktuar edhe afatet përkatëse;
(iii) nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi, në rast të një gjendjeje jo të shëndoshë të bankave, ku përcaktohen në mënyrë të detajuar të gjithë hapat që do të ndërmerren nga menaxherët e bankave për përmirësimin e situatës dhe për shëndoshjen e bankës.
(iv) masa ndëshkuese ndaj administratorëve për shkeljet e konstatuara.

Bankat, në mbështetje të kërkesave dhe të rekomandimeve të dhëna në raportet e ekzaminimit (në krahasim me vitin e kaluar) i kanë kushtuar kujdes plotësimit të akteve të brendshme të tyre në të gjitha fushat e veçanërisht në veprimtarinë krediduese, në

administrimin e të drejtave dhe të detyrimeve, në administrimin e rreziqeve të ndryshme etj..

Bankat po familjarizohen me nevojën e respektimit të ligjit, të akteve nënligjore dhe të rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë. Këto krijojnë premisa, për zhvillimin e marrëdhënieve korrekte midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë.

3.3. Licencimi dhe rregullimet bankare

3.3.1. Licencimi

Kuadri ligjor dhe rregullator për licencimin e subjekteve gjatë këtij viti nuk ka ndryshuar. Mbështetur në kuadrin ekzistues, gjatë vitit 2001 i është dhënë miratimi paraprak për të kryer veprimtari bankare Bankës Tregtare të Kuvaitit (të propozuar) e cila është në procesin e formimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit që do të paraqisë për t'u pajisur me licencën për të filluar të veprojë si bankë. Gjatë këtij procesi banka në fjalë njoftoi për ndryshimin e emrit të saj. Regjistrimi i saj në Gjykatën e Rrethit të Tiranës është bërë me emrin "Banka e Kreditit të Shqipërisë". Në bazë të biznesplanit të paraqitur në Bankën e Shqipërisë për marrjen e licencës për kryerjen e aktivitetit bankar, banka premton të jetë aktive në aktivitetin kredidhënës, ndaj dhe emrin e vendosi të tillë.

Banka e Shqipërise, duke qenë e interesuar për zhvillimin e sistemit bankar, si në drejtim të shtimit të numrit të bankave, rritjen e konkurrencës në sistem, sjelljen e një eksperience të re dhe aq më tepër, shtimin e aktivitetit kredidhënës, për të cilin kjo bankë premton, e mbështeti këtë inisiativë.
Stafi drejtues i bankës së propozuar përbëhet nga specialistë me eksperiencë në lëmin bankar.

Numri i bankave që veprojnë në Shqipëri, për vitin 2001 ka mbetur 13, por është shtuar numri i degëve të këtyre bankave brenda vendit.

Mbështetur në kuadrin rregullativ, të miratuar për licencimin e subjekteve financiare jobanka në Republikën e Shqipërisë, janë licencuar si subjekte financiare jobanka: shoqëritë Alba - Post sot (Posta Shqiptare) Sh.a. dhe "Credins" Sh.a.

Posta Shqiptare Sh.a. është licencuar nga Banka e Shqipërisë si "Subjekt financiar jobankë" për të ushtruar veprimtarinë financiare të ofrimit të shërbimeve të arkëtimit dhe të pagesave. Ky veprim do të kryhet vetëm në zyrat e saj në Tiranë.

Gjithashtu, më 13.06.2001, shoqëria "Credins" Sh.a. është licencuar nga Banka e Shqipërisë si "Subjekt financiar jobankë" për të ushtruar veprimtaritë financiare: të kredidhënies; të shërbimit të pagesave dhe arkëtimeve; të ndërmjetësimit për transaksione monetare (duke përfshirë valutat); të ofrimit të garancive etj..

Subjekte të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë janë dhe zyrat e këmbimeve valutore, të cilat licencohen dhe veprojnë mbështetur në rregulloren: "Për veprimtarinë valutore" dhe udhëzimet e saj. Gjatë vitit 2001 janë licencuar 18 zyra të këmbimeve valutore të reja.

Gjatë vitit 2001 në Shqipëri kanë patur licencë për të vepruar subjektet e mëposhtme:

Banka tregtare dhe degë të bankave të huaja	**13**
Zyra këmbimi valutor	**38**
Subjekte financiare jobanka	**4**

3.3.2. Kuadri rregullator mbikëqyrës

Kuadri rregullator mbikëqyrës i nxjerrë nga Banka e Shqipërisë për një mbikëqyrje të kujdesshme të veprimtarisë së bankave, në përgjithësi mund të quhet i plotësuar. Por plotësimi dhe saktësimi i tij është një proces i vazhdueshëm, që lidhet me:

1. ndryshimet në standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes bankare;
2. probleme të identifikuara nga inspektimet në vend në banka;
3. probleme të dala nga implementimi i rregulloreve ekzistuese;
4. rekomandime të organizmave ndërkombëtarë si FMN, Banka Botërore etj.

Gjatë vitit 2001, rregullimet bankare kanë synuar të rishikojnë të gjithë kuadrin rregullator mbikëqyrës. Rishikimi i kuadrit rregullator mbikëqyrës kishte të bënte me dy aspekte kryesore, e para rishikimin e përgjithshëm të disa rregulloreve dhe e dyta përmirësimin kuptimor të disa të tjerave.

Në këtë aspekt janë:
A) Rishikuar në mënyrë të përgjithshme dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës :
1. rregullorja "Për veprimtarinë valutore", me vendimin nr. 12, datë 21.02.01.
Rishikimi i rregullores kishte për synim rritjen e kufirit të lejueshëm të transfertave të individëve nga brenda–jashtë territorrit të Republikës së Shqipërisë nga 10 mijë dollarë amerikanë në 20 mijë dollarë amerikanë, saktësime lidhur me transfertat tregtare kur pagesa kryhet si para ashtu dhe pas mbërritjes së mallit etj. ;

2. rregullorja "Për menaxhimin e riskut të kredisë", me vendimin nr. 13, datë 21.01.01.

Rishikimi synoi në përcaktimin e pozicionit financiar të kredimarrësit si parësor në vlerësimin e cilësisë së portofolit të kredisë;

3. rregullorja "Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare", me vendimin nr. 42, datë 06.06.01.
Në rregullore u saktësuan kriteret e një investimi të lirshëm dhe atij të miratuar nga Banka e Shqipërisë, të bankave në kapitalin e shoqërive tregtare , të ndryshme nga bankat dhe institucionet financiare.

B) Përmirësuar dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës:
1. udhëzimi "Për kapitalin rregullator", me vendimin nr. 40, datë 16.05.01. Në formularin e raportimit të kapitalit rregullator u shtua pjesa që reflekton elementet që zbriten nga kapitali rregullator si detyrim i rregulloreve "Për menaxhimin e riskut të kredisë", "Për investimet në kapitalin e shoqërive tregtare", "Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal, për veprimtaritë e lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara";
2. rregullorja " Për risqet e mëdha", me vendimin nr. 92, datë 05.12.01. Në këtë rregullore u diferencua kufiri i ekspozimit ndaj rrezikut për përftuesin bankar dhe për

përftuesin jobankar;

3. rregullorja “Për risqet e tregut”, me vendimin nr. 98, datë 19.12.01. U saktësuan rastet e plotësimit dhe të raportimit kur bankat dhe degët e bankave të huaja janë ose jo subjekte të kësaj rregulloreje.

C) Miratuar si plotësim i kuadrit rregullativ:
Udhëzimi: “Për çertifikatat e depozitave”, me vendimin 79, datë 03.10.01 të Këshillit Mbikëqyrës.
Hartimi i këtij udhëzimi u bë i nevojshëm në plotësim të: “Manualit të Kontabilitetit bankar”, për të disiplinuar në një kuadër më të gjerë emetimin, përdorimin dhe kontabilitetin e çertifikatave të depozitave, si një produkt i ri bankar.

Banka e Shqipërisë si autoriteti, që do të licencojë dhe do të mbikëqyrë shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, është angazhuar në përgatitjen e akteve rregullative për këtë qëllim.

Eurozona dhe bankat qendrore

Ndryshimet që ndodhën si rezultat i futjes në qarkullim të euros si monedhë fizike dhe roli që tashmë luan Banka Qendrore Europiane, nuk ulin **rolin e bankave qendrore** të vendeve të veçanta lidhur me mbikëqyrjen e kujdesshme. Në disa raste janë bërë propozime për reduktimin e rolit të bankave qendore, duke rritur përgjegjësinë e agjencive të veçanta për mbikëqyrjen. Megjithatë, bankat qendrore ose janë direkt përgjegjëse për një mbikëqyrje të kujdesshme, ose kanë marrëdhënie shumë të ngushta me agjencitë mbikëqyrëse. Eurosistemi mbështet fuqishëm vazhdimin dhe forcimin e rolit të bankave qendrore të vendeve të veçanta, për një mbikëqyrje të kujdesshme.

4. LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË, DERI MË 30 QERSHOR 2002

4.1. Banka dhe degë të bankave të huaja

1. BANKA ITALO - SHQIPTARE
Licenca Nr. 1/1996, datë 17.07.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 89, datë 18.06.1998.
Drejtori : Adrian FULLANI
Adresa : Rruga "Barrikadave", Nr. 70, Tiranë
Tel. central : 356 97, 356 98, 262 62
Faks : 330 34

2. BANKA E KURSIMEVE
Licenca Nr. 2/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998.
Drejtori : Edvin LIBOHOVA
Adresa : Rr. “Dëshmorët e 4 Shkurtit” Nr.6, Tiranë
Tel. central : 245 40, 226 69, 254 16
Faks : 235 87, 236 95, 240 51

3. BANKA ARABO-SHQIPTARE ISLAMIKE
Licenca Nr. 3/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, datë 11.12.1998.
Drejtori : Abdul Waheed ALAVI
Adresa : Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 8, Tiranë
Tel. central : 284 60, 238 73, 274 08
Faks : 284 60, 283 87

4. BANKA DARDANIA
Licenca Nr. 5/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 01.12.1998.
Drejtori : Beqir MEZELXHIU
Adresa : Bulevardi "ZOGU I" (pranë Fakultetit të Shkencave), Tiranë
Tel. central : 228-759, 259-350, 259-351
Faks : 230-566
Teleks : 2298 db banc ab
Email : db@albaniaonline.net ; dardaniabank@hotmail.com .

5. BANKA KOMBËTARE TREGTARE
Licenca Nr. 6/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, datë 11.01.1999.
Drejtori : Seyhan PENCAPLIGIL
Adresa : Bulevardi “Zhan Dark” Tiranë,
Tel: : (0)4250 955
Faks: : 4250 956

6. BANKA TIRANA
Licenca Nr. 07, datë 12.09.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996.
Drejtori : Dimitris KARAVIAS
Adresa : Bulevardi "ZOGU I", Nr. 55/1, Tiranë
Tel. central : 334 41, 42, 43, 44, 45, 46,47
Faks : 334 17

7. DEGA E BANKËS KOMBËTARE GREKE TIRANË
Licenca Nr. 08, datë 25.11.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4. datë 14.03.1996.
Drejtori : Vasilios FILIS
Adresa : Bulevardi "ZOGU I", Nr. 72, Tiranë
Tel. central : 336 21, 336 22, 336 23, 336 24.
Faks : 336 13

8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE
Licenca Nr.09, datë 20.02.1997.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 30.04.1996.
Drejtori : Lee Chong Pa
Adresa : Rr. “Ded Gjon Luli”, Tiranë
Tel. central : 37567, 37568, 37569
Telfaks :.37570

9. DEGA NË TIRANË E BANKËS ALPHA
Licenca Nr.10, datë 07.01.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.01/03/96,
datë 27.12.1997.
Drejtori : Andrea Antonios GALATOULAS
Adresa : Bulevardi "ZOGU I", Nr.47, Tiranë
Tel. : 335 32, 333 59, 404 76, 404 77
Telfaks : 321 02

10. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË
Licenca Nr.11, datë 10.08.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 10.08.1998.
Drejtori : Lorenzo RONCARI
Adresa : Rruga “Ismail Qemali” Nr.27, P.O. Box 8319 – Tiranë
Tel. : 48753/4/5/6
Telfaks : 487 62

11. BANKA FEFAD SH.A.
Licenca Nr. 12, datë 15.03.1999
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 03.03.1999.
Drejtori : Emmanuel DECAMPS
Adresa : Rruga “Sami Frashëri”, Tirana e Re, P.O. Box. 2395, Tiranë
Tel. : 304 99, 334 96
Telfaks : 334 81

12. DEGA NË TIRANË E BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SH.A.
Licenca Nr. 13, datë 16.04.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.45, datë 13.04.1999.
Drejtori : Petar Gavrillov KRASTEV
Adresa : Bulevardi "ZOGU I", Nr. 64, Tiranë
Tel. : 564 23, 564 24
Telfaks : 564 22

13. BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI) SH.A.
Licenca Nr. 14, datë 28.10.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.
Drejtori : George CARACOSTAS
Adresa : Rruga "Kavajës", “Tirana Tower”, Tiranë
Tel. : 587 55, 56, 57, 58, 59, 60
Telfaks : 587 52

4.2. Subjekte jobanka

1. Unioni Financiar i Tiranës Sh.p.k. (UFT)
Licenca nr. 1, datë 08.12.1999 për të ushtruar veprimtaritë financiare:

- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare;
- agjente apo këshilltare financiare .

Drejtor : Niko Leka
Adresa: Rruga Ismali Qemali nr.32/1, Tiranë.

2. Diners Club Albania Sh.p.k.
Licenca nr. 2, datë 09.10.2000 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare .

Drejtor : Vebi Velia
Adresa : Rruga Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.

3. Posta Shqiptare Sh.a.
Licenca nr. 3, datë 18.04.2001 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve.

Ky veprim do të kryhet vetëm në zyrat e saj në Tiranë.
Pronësia : Shtetërore
Drejtore : Zj.Aleksandra Çollaku
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku” , nr.4 Tiranë.

4. “CREDINS” Sh.a. Tiranë.
Licenca nr. 04, datë 13.06.2001 për të ushtruar veprimtarinë financiare:

- të dhënies kredi;
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të ofrimit të garancive;
- agjente ose këshilltare financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikën 3/a dhe 3/b të nenit 26 të ligjit: “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”).

Drejtore : Zj. Monika Milo
Adresa : Rruga "Ismail Qemali" Nr.21, Tiranë
Nr.Tel : 222916; 234096.

5. “Fondi i Financimit të Zonave Malore”.
Licenca nr. 5, datë 29. 03.2002 si subjekt financiar jobankë për të ushtruar veprimtarinë e mëposhtme:

- të japë kredi.

Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Drejtori : Arben Jorgji
Adresa : Rruga "Mustafa Matohiti" Vila nr.12, Tiranë
Tel.: : 250633

Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: “Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998. “Për bankat në Republikën e Shqipërisë.”.

(Këto subjekte nuk licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, por kanë detyrimin të raportojnë në Bankën e Shqipërisë).

1. Fondi i Financimit Rural.
- Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 28.04.1999.
- Objekti i veprimtarisë: Financimi i zonave rurale.
- Selia: Rr."Ismail Qemali", P. 32, Tiranë
- Drejtor: Zana Konini
- Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr.1843, datë 01.08.2000.

2. Fondacioni Besa.
- Themeluar nga “Fondi i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë” (SOROS).
- Objekti i veprimtarisë: Financimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla.
- Selia: Rr."Asim Vokshi", Nr. 35, Tiranë
- Drejtor: Bajram Muça
- Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 2895/1, datë 19.01.2001.

3. Partneri Shqiptar për Mikrokredinë.
- Aksioner: “Opportunity International”(East Europe).
- Objekti i veprimtarisë: Kredidhënia.
- Adresa: Rr. "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë
- Drejtor: James Reiff
- Përjashtuar me shkresën e Bankës së Sqipërisë nr. 828/1, datë 08.04.2002.

4.3. Zyra të këmbimeve valutore

1. Zyra e Këmbimeve Valutore "JOARD" Sh.p.k. **,Tiranë**
Licenca: Nr. 1, datë 01.10.1999
Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli" Nr.2, Tiranë

2. Zyra e Këmbimeve Valutore "AMA" Sh.p.k., **Durrës**
Licenca: Nr. 2, datë 01.10.1999
Adresa: Rruga "Tregtare", Lagja 3, Durrës

3. Zyra e Këmbimeve Valutore "ARIS" Sh.p.k.**, Tiranë**
Licenca: Nr. 3, datë 01.10.1999
Adresa: Rruga "Luigj Gurakuqi" , Tiranë

4. Zyra e Këmbimeve Valutore "UNIONI FINANCIAR TIRANË" Sh.p.k.
Licenca: Nr. 4, datë 01.10.1999
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Pall. Shallvare, Shk. 2/18, Tiranë

5. Zyra e Këmbimeve Valutore "AGLI" Sh.p.k.**,Tiranë**
Licenca: Nr. 5, datë 01.10.1999
Adresa: Agjencia 1: Rruga "Islam Alla" Nr.1, Tiranë
Agjencia 2: Rruga "Kavajës", pranë Pastiçeri "Rinia", Tiranë

6. Zyra e Këmbimeve Valutore "ALBAKREDIT" Sh.p.k.**,Tiranë**
Licenca: Nr. 06, datë 24.11.1999
Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli" Nr.5, Tiranë

7. Zyra e Këmbimeve Valutore "GUDEN" Sh.p.k.**,Tiranë**
Licenca: Nr. 07, datë 24.11.1999
Adresa: Rruga "Konferenca e Pezës" , Tiranë

8. Zyra e Këmbimeve Valutore "EXCHANGE" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 08, datë 24.11.1999
Adresa: Rruga "Durrësit" Nr. 170 dhe "Reshit Çollaku" , Pall. Shallvare Shk. 4, Ap.42, Tiranë

9. Zyra e Këmbimeve Valutore "UNISIX" Sh.p.k., **Korçë**
Licenca: Nr. 09, datë 26.11.1999
Adresa: Bulevardi "Republika", Pall.4, Korçë

10. Zyra e Këmbimeve Valutore "EKSPRES J & E" Sh.P.K., Durrës
Licenca: Nr. 10, datë 26.11.1999
Adresa: Lagja 11, Rruga "Prokop Meksi" (pranë Hotel "Durrësi"), Durrës

11. Zyra e Këmbimeve Valutore "MI & CO" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 11, datë 29.02.2000
Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.2/3, Tiranë

12. Zyra e Këmbimeve Valutore "ILIRIA '98" Sh.p.k., TIRANË
Licenca: Nr. 12, datë 25.02.2000
Adresa: Sheshi "Skenderbej", Teatri i Kukullave, Tiranë

13. Zyra e Këmbimeve Valutore "SERXHIO" Sh.p.k., Elbasan
Licenca: Nr. 14, datë 07.04.2000
Adresa: Lagja "Luigj Gurakuqi", Rr.11 Nëntori, Pall. 70, Nr.14, Elbasan

14. Zyra e Këmbimeve Valutore "ALBTUR" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 15, datë 07.04.2000
Adresa: Agjensia nr.1, Bulevardi "Zogu I", Pall. 32, Shk.1 (përballë Bankës Tirana), Tiranë
Agjencia nr.2 Rruga "Mine Peza", Pall. 102, Shk.1 (pranë Bar Grand), Tiranë

15. Zyra e Këmbimeve Valutore "R & M" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 16, datë 22.05.2000
Adresa: Rruga "Punëtorët e Rilindjes", Pall. 182, Tiranë

***16.* Zyra e Këmbimeve Valutore "TEUTA 2000" Sh.p.k., Durrës**
Licenca: Nr. 17, datë 22.05.2000.
Adresa: Lagja 4, Rruga "Skëndërbej", Ap. 950, Durrës

17. Zyra e Këmbimeve Valutore "T & E" Sh.p.k., Durrës
Licenca: Nr. 18, datë11.06.2000
Adresa: Lagja 4, Rruga "9 Maji", Durrës

18. Zyra e Këmbimeve Valutore "SUELA" Sh.p.k., Durrës
(revokuar licenca, me shkresën nr. 2190 datë 27.08.2001)
Licenca: Nr. 18, datë 20.10.2000.
Adresa: Porti Detar, Ambjentet e Interklubit, Durrës

19. Zyra e Këmbimeve Valutore "SHIJAK 2000" Sh.p.k., Shijak
Licenca: Nr. 19, datë 24.11.2000
Adresa: Lagja "Popullore", Shijak

20. Zyra e Këmbimeve Valutore "R & T" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 20, datë 20.12.2000
Adresa: Bulevardi "ZOGU I", (pranë BPI-së), Tiranë

21. Zyra e Këmbimeve Valutore "DV-ALBA" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 21, datë 11.01.2001
Adresa: Sheshi "Skënderbej", Tirana Internacional Hotel,Tiranë

22. Zyra e Këmbimeve Valutore "MANUSHI" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 22, datë 18.04.2001
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë

23. Zyra e Këmbimeve Valutore "UNIONI SELVIA" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 23, datë 21.05.2001
Adresa: Rruga "Saraçëve", Pallati 124/1, Tiranë
Tel. 376 274

24. Zyra e Këmbimeve Valutore "KALENJA" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 24, datë 29.06.2001
Adresa: Rruga "Kavajës" (pranë Ambasadës Turke), Tiranë

25. Zyra e Këmbimeve Valutore "TILBA" Sh.p.k., Elbasan
Licenca: Nr. 25, datë 30.09.2001
Adresa: Lagja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Qemal Stafa", Njësia nr.12, Elbasan

26. Zyra e Këmbimeve Valutore "ANAGNOSTI" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 26, datë 31.10.2001.
Adresa: Bulevardi Zogu I, Pallati 97, shk.3.ap28, Tiranë
Tel: 0382126326

27. Zyra e Këmbimeve Valutore "KO-GO" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 27, datë 12.11.2001
Adresa: Rruga "Vaso Pasha", Pall.16, Shk.2, Ap. 9, Tiranë
Tel: 0382024230

28. Zyra e Këmbimeve Valutore "ALB- FOREX" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 28, datë 22.11.2001
Adresa: Rruga "Abdyl Frashëri Nr.3., Tiranë
Tel.: 0382045287

29. Zyra e Këmbimeve Valutore "L&N" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 29, datë 22.11.2001
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", ish Gjelltorja tek sheshi ATATURK, Tiranë
Tel.: 268393

30. Zyra e Këmbimeve Valutore "TERBACI- GJ" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 30, datë 22.11.2001
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Pall.215, Kati I(dyqanet), Tiranë
Tel: 0382134574

31. Zyra e Këmbimeve Valutore "EXHANGE ALOG" Sh.p.k., Tiranë
Licenca: Nr. 31, datë 22.11.2001
Adresa: Rruga "Mine Peza" (përballë selisë së Vatikanit), Tiranë
Tel: 0382041200; 0382022334

32. Zyra e Këmbimeve Valutore "EX-CHANGE BEBI&FLORI" Sh.p.k., FIER
Licenca: Nr. 32, datë 26.11.2001
Adresa: Lagja "Kongresi i Përmetit", Fier
Tel: 0382035654

33. Zyra e Këmbimeve Valutore "GERSILDA" Sh.p.k., TIRANË
Licenca Nr. 33, datë 03.12.2001
Adresa: Lagja nr.2, Rr. "Mihal Grameno", Pall.10, dyqani nr.5, Tiranë
Tel: 0382051110

34. Zyra e Këmbimeve Valutore "CHANGE-ARIZAJ" Sh.p.k., TIRANË
Licenca: Nr. 34, datë 03.12.2001
Adresa: Rr. "Pandi Madhi", Pall.60/2, Ap.15, Tiranë
Tel.: 0382135394

35. Zyra e Këmbimeve Valutore "BASHKIMI 2001" Sh.p.k., TIRANË
Licenca: Nr. 35, datë 12.12.2001
Adresa: Rr. "Kavajës" (lokali Pastiçeri "Rinia"), Tiranë
Tel: 0382024601

36. Zyra e Këmbimeve Valutore "ARJON 2002" Sh.p.k.
Licenca: Nr. 36, datë 14.12.2001
Adresa: Lagja "Kongresi i Elbasanit", Bulevardi"Qemal Stafa", Pall.9-katësh, Elbasan
Tel.: 054 584 60, 054 578 27, 0692 107 7887

37. Zyra e Këmbimeve Valutore "AEDA TURIST" Sh.p.k.
Licenca: Nr. 37, datë 14.12.2001
Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nr. 5, Tiranë
Tel.: 256 658

38. Zyra e Këmbimeve Valutore "JONI" Sh.p.k. Kavajë
Licenca Nr. 38, datë 18.12.2001
Adresa: Lagja nr.3, Rr. "3 dëshmorët", Kavajë
Tel.: 0382163013; 0574 3734

39. Zyra e Këmbimeve Valutore "Euro 2002" Sh.p.k. Durrës
Licenca: Nr. 39, datë XX.12.2001
Adresa: Lagja nr.11, Rr. "Ismail Qemali", pranë PTT, Durrës
Tel.: 0692135741; 0382152743

40. Zyra e Kembimeve Valutore "Euro Travels International" Sh.p.k. Tiranë
Licenca Nr. 40, date 14.01.2002.
Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", pallatet Agimi Nr.1, Tiranë,
Kambist**:** **Arben Dusha**;
Tel.: 224942;
E mail: bdusha51@Yahoo.com.

41. Zyra e Kembimeve Valutore "G&3" Sh.p.k. Kavajë,
Licenca Nr. 41, date 15.01.2002.
Adresa: Rruga"Kajo Karafili", Kavajë,
Kambist**:** **Galip Rrena, Gazmend Rrena, Gëzim Rrena**;
Tel.: 05742739; 0382279094;

42. Zyra e Kembimeve Valutore "ALAKTH" Sh.p.k. Tiranë,
Licenca Nr. 42, date 18.01.2002.
Adresa: Rruga e Dibrës,nr.105/1, Tiranë,
Kambist**:** **Kosta Papa, Arben Memko,Lorenc Konomi, Thoma Konomi, Aleko Plaku**;
Tel.: 0382026363;

43. Zyra e Kembimeve Valutore "Format" Sh.p.k. Tiranë,
Licenca Nr. 43, date 21.01.2002.
Adresa: Rruga e Durrësit,Pall.85, shk.1,ap.1, Tiranë,
Kambist**:** **Diana Lemi,** Egon Sinani;
Tel.: 221606;

44. Zyra e Kembimeve Valutore "TRI URAT" Sh.p.k. Elbasan,
Licenca Nr. 44, date 05.02.2002.
Adresa: Lagja "29 nentori", prane filialit te postes Elbasan,
Kambist**:** **Fahri Sanco, Ismail Bejta**;
Tel.: 0382262233; 0382133184.

45. Zyra e Kembimeve Valutore "CROËNTONË" Sh.p.k. Tiranë,
Licenca Nr. 45, date 05.02.2002.
Adresa: Rruga "Mihal Grameno", Pall 010,Tiranë
Kambist**:** **Silvana Xhaferri,** Albana Dangaj, Shemsi Hoxha;
Tel.: 04223 544.

46. Zyra e Kembimeve Valutore "BESA 2001" Sh.p.k. Tiranë,
Licenca Nr. 46, date 15.02.2002.

Adresa: Rruga “Myslym Shyri”, Nr.25,Tiranë
Kambist**:** **Belul Lleshi, Vladimir Avda,** Mimoza Avda;
Tel.: 0382133879.

47. Zyra e Kembimeve Valutore “MARIO” Sh.p.k. Sarandë,
Licenca Nr. 47, date .03.2002.
Adresa: Lagja 1, prane ishkomitetit ekzekutiv te rrethit Saranda.
Kambist**:** **Vangjel Gramozi, Blerim Dhima**;
Tel.: 0732 38 33, 0732 29 85, 00355973708363.

48. Zyra e Kembimeve Valutore “R&T EXCHANGE” Sh.p.k. Tiranë,
NDRYSHUAR EMRIN NE “JAV” SHPK
Licenca Nr. 48, date 20. 03.2002.
Adresa: Bulevardi Zogu I Godina e Zerit te Popullit Tirane.
Kambist**:** **Ervin Lera,** Ilir Gurashi;
Tel.: 0382023214.

49. Zyra e Kembimeve Valutore “DROGU” Sh.p.k. Tiranë,
Licenca Nr. 49, date 23 .04.2002.
Adresa: Rruga “Vaso Pasha” Kulla 1, Kati I (pas pallatit Agimi) Tirane.
Kambist**:** **Shkelqim Drogu,** Kostandin Koteci;
Tel.: 240534, 0382045031.

50. Zyra e Kembimeve Valutore “HYSEN-C” Sh.p.k. Laç,

Licenca Nr. 50, date 23 .04.2002.
Adresa: Lagja nr.3, perballe Komisariatit te Policise, Laç.
Kambist**:** **Cen Hyseni**;
Tel.: 0382024688.

51. Zyra e Kembimeve Valutore “UNIONI FIER” Sh.p.k. Fier,

Licenca Nr. 51, date .05.2002.
Adresa: Lagja 15 Tetori, Rruga Kastriot Muca, Fier.
Kambist**:** **Gjergj Dulaj**; Lartim Isufaj.
Tel.: 064 25 554.

52. Zyra e Kembimeve Valutore “TAXI EKSPRES” Sh.p.k. Elbasan,

Licenca Nr. 52, date 20.05.2002.
Adresa: rruga Sami Frasheri, 11(prane Shkolles “Edit Durhan”.
Kambist**:** **Arben Sharra,** Sokol Kaleci.
Tel.: 223231, 0382046099, 0382250566.

53. Zyra e Kembimeve Valutore “MERO” Sh.p.k. Devoll,

Licenca Nr. 53, date.05.2002.

Adresa: Zyra nr.1 : Bulevardi Fuat Babani, Bilisht.
Zyra nr.2 : Dogana Kapshtice
Kambist: Gezim Demcolli, Valter Miza, Genti Mahmutaj, Albert Haxhia, Edmond Miza.
Tel.: 085 22 331; 0382029748.

5. LISTA E RREGULLOREVE TË MBIKËQYRJES BANKARE NË FUQI DERI NË QERSHOR 2002

1 – Rregullorja: **"Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.173, datë 02.12.1998; një shtesë miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.43, datë 17.05.2000.

2 – Rregullorja: **"Mbi kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 17.02.1999 dhe një ndryshim i kësaj rregulloreje me vendimin nr.17, datë 01.03.2000.

3 – Rregullorja: **"Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 18.03.1999.

4 – Rregullorja: **"Për menaxhimin e riskut të kredisë",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.13, datë 21.02.2001**.** Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 3. Ndryshuar me vendimin nr.32, datë 08.05.2002. Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 4, numër 5.

5 – Rregullorja: **"Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal, për veprimtaritë e lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 51, datë 22.04.1999.

6 – Udhëzimi: **"Për kapitalin rregullator",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 57, datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.40, datë 16.05.2001. Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 6.

7 - Rregullorja: **"Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 05.05.1999, ndryshimet në rregulloren **"Për mjaftueshmërinë e kapitalit"**, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.86, datë 07.11.2001, botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 12.

8 - Rregullorja: **"Për pozicionet e hapura valutore",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.59, datë 05.05.1999; disa ndryshime në rregullore miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.118, datë 01.12.1999.

9 - Rregullorja: **"Për veprimtarinë valutore",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 21.02.2001**.** Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 3.

10 - Rregullorja: **"Për raportin e likuiditetit",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.71, datë 02.06.1999; shfuqizuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.04, datë 19.01.2000 dhe zëvendësuar me udhëzimin **"Për likuiditetin e bankave",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 04, datë 19.01.2000.

11 - Rregullorja: **"Për risqet e tregut",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës
nr. 72, datë 02.06.1999, një ndryshim miratuar me vendimin Këshillit Mbikëqyrës nr. 98, datë 19.12.2001. Ndryshimi botuar në Buletimin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 13.

12 - Rregullorja: **"Për kontrollin e risqeve të mëdha",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.78, datë 07.07.1999; disa ndryshime në rregullore miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.119, datë 01.12.1999; disa ndryshime me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.92, datë 05.12.2001. Ndryshimi i fundit botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 13.

13 - Udhëzimi: **"Për kontrollin e brendshëm në banka",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.107, datë 03.11.1999.

14 – Rregullorja: **"Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare"** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.42, datë 06.06.2001. Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 7.

15 - Rregullore: **"Për bankat kooperativë**" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 29.03.2000.

16 – Udhëzim: **"Mbi menaxhimin e rrezikut të normës së interesit",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.61, datë 05.07.2000.

17 - Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.26, datë 29.03.2000 **"Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit: "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"".**

18 – Rregullorja: **"Për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare"** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 06, datë 05.07.2000.

19. – Udhëzimi: **"Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave dhe të degëve të bankave të huaja",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 39, datë 16.05.2001. Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 6.

20. - ***"Sistemi i raportimit të shoqërive të kursim-kreditit"*** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.75, datë 05.09.2001. Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 10.

21. – Udhëzimi: **"Për çertifikatat e depozitave",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.79, datë 03.10.2001. Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 11.

22. – Udhëzim: **"Për parandalimin e pastrimit të parave",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.102, datë 29.12.2001. Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 3, numër 14.

23. - Rregullorja: **"Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit",** miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.11, datë 27.02.2002. Botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë vëllimi 4, numër 2.

24. - Udhëzimi **"Për kujdestarinë dhe likujdimin e bankave**"miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.45, datë 12.06.2002.